



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 601 Prot.

Tiranë, më datë 24.10.2025

VENDIM

Nr. 542, datë 24.10.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.10.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e Konceptit të sondazheve arkeologjike të hartuar në kuadër të projektit “*Salterra 2 (zhvillimi i një kompleksi turistik me program hoteleri dhe shërbime +8 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë)*”, që ndodhet në Z.K. 3951, Zvërnec, Bashkia Vlorë”, brenda Zonës Mbrojtëse të Kalasë së Treportit dhe murit antik në det, me aplikues Z. Taulant Rama dhe zhvillues **Turi M.Z.B**;
2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për “*Salterra 2 (zhvillimi i një kompleksi turistik me program hoteleri dhe shërbime +8 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë)*”, që ndodhet në Z.K. 3951, Zvërnec, Bashkia Vlorë”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Rezultati i sondazheve arkeologjike do të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

